



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 201500284/3

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2015

**Lënda:** Rekomandohet "Fillimi i hetimit për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare", në ngarkim të punonjësit të Komisarariatit të Policisë, R. M., parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal dhe ndaj zv/drejtorit të Policisë A. H., për veprat penale "Kryerja e veprimeve arbitrare" dhe "Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme", parashikuar nga nenet 250 dhe 251 të Kodit Penal.

**Drejtuar :** Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor  
Z. Alket MERSINI

**KORÇË**

**Për dijeni:** Prokurorit të Përgjithshëm  
Z. Adriatik LLALLA

**TIRANË**

*Të nderuar Zotërinj,*

Avokati i Popullit ka filluar me inisiativë rastin e bërë publik në median vizive, ngjarje e ndodhur në datën 20 Shkurt 2015, në qytetin e Korçës kur nga punonjësit e policisë keqtrajtohet qytetari T. M.

Mbi këtë shqetësim, është urdhëruar kryerja e një hetimi të pavarur administrativ, dhe Ndihmës Komisioneri i Avokatit të Popullit ka shkuar në qytetin e Korçës, ku ka kryer veprime të ndryshme në funksion të hetimit.

Kështu, rreth ores 19.00 të dates 21 Shkurt 2015, janë marrë deklarime të hollësishme shtetasit të dëmtuar T. M., i cili ndodhej i shtruar në repartin e kirurgjisë të Spitalit Rajonal Korçë. Më pas janë marrë deklarime punonjësve të policisë N. B., dhe R. M., kurse zv/drejtorit të Drejtorisë së Policisë të Qarkut, A. H., më datën 23.02.2015, në Tiranë.

Janë administruar dokumente të ndryshme shkresore si, epikriza e pacientit Tomi Misha, lëshuar nga personeli mjekësor i Spitalit Rajonal Korçë, dhe raportet e shërbimit mbajtur nga punonjësit e policisë lidhur me ngjarjen.

Në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Korçë, jemi informuar për faktin se më datën 21.02.2015, ishte filluar procedimi penal nr.214, për veprat penale të *“Drejtimin të mjetit në gjëndje të dehur”* dhe *“Kundërshtim të punonjësit të policisë të rendit publik”*, parashikuar nga nenet 291 dhe 236 të Kodit Penal, ndaj shtetasit T. M.

Nga hetimi administrativ i deritanishëm rezultoi se:

### **Rrethanat e ngjarjes**

Në ditën e ngjarjes, datë 20.02.2015, shtetasi T. M., nga qyteti i Korçës me mjetin tip “Bens” që ka në pronësi, ka bërë furnizimin me disa artikuj ushqimore për lokalit e babait të tij, i cili ndodhet në malin Morava. Duke ecur përgjatë rrugës në drejtim të katedrales së qytetit, ka goditur me parakolpin e autoveturës “Bens”, mjetin Fuoristradë në ngjyrë gri, me fenelinë policie, e cila drejtohej nga zv/drejtori i Policisë së Qarkut Korçë, A. H.

Pas goditjes së mjetit A. H., ka dalë jashtë dhe ka shkuar tek drejtuesi i mjetit shtetasi T. M., të cilit i ka thënë që të qëndronte aty sa të vinte policia e qarkullimit rrugor, pasi konstatoi se ai ishte i dehur. Ai menjëherë ka komunikuar me sallën operative të Drejtorisë së Policisë për ngjarjen, si dhe njoftimin e policisë rrugore.

Nga ana e tij, shtetasi T. M., i ka kërkuar të falur duke iu lutur për ta lënë të largohej, por zv/drejtori i Policisë e ka sqaruar qytetarin se duhet të qëndronte tek mjeti, me qëllim që policia rrugore të kryente detyrën e saj, pasi ai ishte në gjëndje të dehur. Pasi ka konstatuar vonesa në ardhjen e punonjësve të policisë, zv/drejtori A. H., ka njoftuar përsëri sallën operative, dhe pas disa minutave në vëndin e ngjarjes kanë mbërritur punonjësit e policisë R. M., e N., B. Zv/drejtori i Policisë i sqaroi punonjësit e policisë që pasi t’i bëhej testi i alkoolit nga polici rrugor, drejtuesi i mjetit të shoqërohej në Komisarlatin e Policisë.

Punonjësit e policisë duke parë reagimet e drejtuesit të mjetit T. M., i kanë bërë thirrje që të qetësohej, dhe pastaj i kanë kërkuar çelësat e mjetit për ta drejtuar atë punonjësi i policisë R. M., por ai nuk pranuar dhe ka pretenduar se do ta drejtonte vetë mjetin. Atëhere, punonjësi i policisë R. M., ka dalë jashtë mjetit dhe është drejtuar tek dera e drejtuesit të mjetit duke e nxjerrë atë me forcë dhe pastaj e ka qëlluar disa herë me pëllëmbë e grushte nga fytyra.

Zv/drejtori i policisë z.A. H., ka urdhëruar punonjësit e policisë të marrin forcërisht dhe ta shoqërojnë në Komisarlatin, shtetasin T. M., por ai nuk pranoi të shkojë me ta. Në vëndin e ngjarjes janë grumbulluar dhe persona të tjerë, e pak më vonë ka ardhur shtetasi A.M., vëllai i drejtuesit të mjetit T. M., cili ka qëlluar

me grusht punonjës in e policisë R. M. Pas goditjes ai është kapur nga zv/drejtori i policisë A. H., i cili ka komunikuar me sallën operative për të dërguar forca policie për shkak të precipitimit të situatës. Shtetasi A. M., i është shkëputur nga duart dhe është larguar ndonëse është ndjekur nga zv/drejtori i policisë dhe polici rrugor L. X.

Punonjësit e policisë kanë shoqëruar në Komisarariat me mjetin e policisë shtetasin T. M., duke e futur në dhomën e shoqërimit dhe më pas kanë përpiluar raportin e shërbimit për ngjarjen. Nga Policia Gjyqësore është bërë dhe “Arresti në flagrance” i shtetasit T. M. Po ashtu të shoqëruarit T. M., i është bërë dhe testi i alkoolit nga policia rrugore, i cili sipas pretendimeve të zv/drejtorit A. H., ishte mbi normën e lejuar.

Në deklaratimet e tij shtetasi T. M., ka shpjeguar se pasi është futur në dhomën e shoqërimit, në Komisarariat e Policisë, në dy raste me shkëputje prej rreth 15 minutash, aty ka ardhur zv/drejtori i policisë A. H., i cili e ka goditur me shpulla nga fytyra e barku, e duke i thënë se çfarë të duket vetja ty, ndonëse i dëmtuari ka vazhduar t’i kërkojë të falur.

Pas këtyre veprimeve, shtetasi T. M., ka patur dhimbje të trupit dhe sidomos të shpatullës së djathtë, dhe nga ana e Policisë është transportuar në repartin e kirurgjisë të Spitalit Rajonal Korçë.

### **Mendime dhe përfundime**

Duke analizuar në tërësi ngjarjen dhe provat e administruara rezulton se:

Me mbërritjen në vëndin e ngjarjes, punonjësit e policisë R. M., dhe N. B., u njohën me rrethanat e ndodhjes së saj si dhe me faktin që drejtuesi i mjetit ishte në gjëndje të dehur. Punonjësi i policisë N. B., duke e parë të acaruar drejtuesin e mjetit T. M., i ka bërë thirrje që të qetësohet, kurse kolegu i tij R. M., e ka nxjerrë me forcë nga mjeti duke i shkaktuar dhe dëmtim të shpatullës së djathtë, e më pas ka ushtruar dhunë fizike duke e qëlluar disa herë me pëllëmbë e grushta në fytyrë.

Punonjësit e policisë duke parë se qytetari nuk bindej me fjalë për të shkuar në polici, duhet të përzgjidhnin nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësisve të shkallëzuara në shtrëngimin fizik e në vazhdimësi të mjeteve të tjera goditëse. Këto veprime janë parashikuar në mënyrë të qartë në nenin 118 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit” me ndryshimet përkatëse. Në fakt gjatë zhvillimit të ngjarjes, punonjësi i policisë R. M., ka kryer veprime të dhunshme, në kapërcim të kompetencave, të cilat janë arbitrare dhe të kundërligjshme gjatë ushtrimit të detyrës, me pasoja në shëndetin e qytetarit. Ngjarja e ndodhur, e bërë publike dhe në media, bëhet dhe më flagrante pasi është kryer në mes të ditës dhe në qëndër të qytetit të Korçës, me prani të një publiku të gjërë, çka bie ndesh me nenin 6 të VKM nr.786, date 04.06.2008 “Për miratimin e rregullores së disiplinës së Policisë së Shtetit” dhe me Kodin Etik dhe të Sjelljes së Zyrtarit të Zbatimit të Ligjit. Nga ana tjetër ai bie ndesh dhe me Misionin e Policisë që është ruajtja e rendit dhe sigurisë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, parashikuar në nenin 1 të ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”

Shteti i ka dhënë Policisë përgjegjësi për kryerjen e shërbimeve të policimit në respekt të plotë me shtetin ligjor. Prandaj dhe shërbimet policore duhet t'i përshtaten parimeve të demokracisë, llogari –dhënies dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Nga ana tjetër, zv/drejtori i policisë A. H., ka qënë i pranishëm në ngjarje. Si shpjegon dhe në deklaratimet e tij, ai ka komunikuar disa herë me sallën operative për të ardhur punonjës policie të tjerë për ndihmë, pasi ata po vonoheshin. Ai qëndron indiferent dhe nuk i bën përshtypje fakti kur vartësi tij, punonjësi i policisë kryen veprime flagrante të dhunshme ndaj qytetarit e për rrjedhojë nuk ka marrë asnjë masë për të ndërprerë dhe për t'i dhënë fund gjëndjes së paligjshme. Më konkretisht ai duhet t'i kërkonte punonjësit të policisë R. M., që të ndërpriste veprimet arbitrare në cënim të lirisë së qytetarit T. M.

Veprat penale të mësipërme, janë realizuar gjatë ushtrimit të detyrës nga të dy punonjësit e Policisë së Shtetit dhe për rrjedhojë janë cënuar marrëdhënie juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt shtetërore ose shërbimin publik, që kanë të bëjnë me respektimin e lirive të shtetasve, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Gajtë hetimit administrativ të kryer, deklaruesit kanë dhënë shpjegime lidhur me ngjarjen, ndonëse kanë patur dhe kontradikta në thëniet e tyre.

Është detyra e organit procedues që të kryejë hetime objektive dhe të gjithanshme, për të sqaruar pozitën procedurale të gjithësecilit në hetimin e çështjes penale, apo dhe motivet e kryerjes së veprave penale.

Nga ana tjetër, organi procedues duhet t'i shtrijë hetimet dhe në drejtim të dëmtimeve të shkaktuara qytetarit T. M., duke kërkuar kryerjen e ekspertimit mjeko ligjor me grup ekspertësh.

Nga provat e administruara, si deklaratimet e shtetasve T. M., N. B., R. M., e A. H., apo dhe akteve të ndryshme dokumente shkresore epikriza për pacientin T. M., raportet e shërbimit, aktet e ekspertimit mjeko ligjor etj, del e qartë se punonjësi i Policisë R. M., ka kryer veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, ndërsa zv/drejtori i Policisë, A. H., veprat penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare” dhe “Mosmarrjes së masave për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme”, parashikuar nga nenet 250 dhe 251 të Kodit Penal.

Për sa sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “ç” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, i rekomandon Prokurorisë të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”.*

## **REKOMANDOHET**

“Fillimi i hetimit, për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, ndaj punonjësit të Komisarariatit të Policisë Korçë, R. M., parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal dhe ndaj zv/drejtorit të Policisë së Qarkut Korçë A. H., për veprat penale “Kryerja e veprimeve arbitrare” dhe “Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme” parashikuar nga nenet 250 dhe 251 të Kodit Penal.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur ju dërgojmë fotokopje të deklarimeve të shtetasve T. M., R. M., N. B., A. H., epikrizën e pacientit T. M., dhe dy raporte shërbimi.

*Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.*

**AVOKATI I POPULLIT**

**Igli TOTOZANI**